



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVO	
KOMUNA E VUSHTRRISE-OPŠTINA VUČITRAN	
Nr. / Nr. / Nr.	689/17
Nr. / Nr. / Nr.	
Data / Datum	02.06.2017
VUSHTRRI - VUČITRAN	



REPUBLIKA E KOSOVËS - KOMUNA VUSHTRRI
Kryetari

Bazuar në nenin 13 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040 dhe nenin 67, "g" të Statutit të Komunës, Kryetari i Komunës merr këtë:

V E N D I M

1. Lejohet mbushje mujore e telefonisë mobile të Vala-s për këta zyrtar të komunës:
 - 1.1 Hyda Dallku, 10.00 €.
 - 1.2 Xhafer Islami, 10.00 €.
2. Për zbatimin e këtij vendimi obligohet Drejtoria për Buxhet dhe Financa.
3. Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit dhe duhet të zbatohet nga data 01.07.2017.
4. Vendimi i dërgohet, Drejtorisë për Buxhet dhe Financa dhe Arkivit të Sekretarisë.



Kryetari i Komunës

Bajram Mulaku



REPUBLICA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVO
KOMUNA E VUSHTRRIË-OPËTINA VUÇITRN

02 Nr. / Nr. _____ 692/17

Nr. i Sj. / Ilic. et _____

Data / Datum _____ 05. 06. 2017

VUSHTRRI - VUÇITRN



REPUBLICA E KOSOVËS - KOMUNA VUSHTRRI
Kryetari

Bazuar në nenin 13 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040 dhe nenin 67, "f" dhe "g" të Statutit të Komunës, Kryetari i Komunës merr këtë:

V E N D I M
PËR FORMIM TË KOMISIONIT

1. Me këtë vendim formohet komisioni për evidentimin e familjeve të cilat banojnë në objektin e ish ambulancës së vjetër dhe barakën e ish union investit në këtë përbërje:
 - 1.1 Naim Ferizi, kryesues i komisionit
 - 1.2 Fitore Hyseni, anëtare
 - 1.3 Abaz Shyti, anëtar
2. Komisioni në përbërje të cekur në pikën paraprake duhet të bëjë evidentimin e familjeve të vendosura në ish ambulancës së vjetër dhe barakën e ish union investit në Vushtri, gjendjen e tyre ekonomike si dhe të gjej mundësi për zhvendosjen e tyre brenda një afati të arsyeshëm kohorë për shkak se: në barakën në rr. "Jeton Tërstena" është bërë privatizimi i asaj prone si dhe është kërkuar që të lirohet ai objekt. Ndërsa objekti i ish ambulancës së vjetër pritet së shpejti të filloj renovimi i tij.
3. Komisioni duhet të paraqes propozim konkret për të gjetur zgjidhje të zhvendosjes apo zgjidhje tjetër të pranueshme për ato familje.
4. Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.
5. Vendimi i dërgohet anëtarëve të komisionit dhe arkivit të sekretarisë.



Kryetari i Komunës

Bjram Mulaku



REPUBLIKA E KOSOVËS - KOMUNA VUSHTRRI

Kryetari

Bazuar në nenin 13 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040 dhe nenin 67, "f" dhe "g" të Statutit të Komunës, pikës 2 të Vendimit të Kuvendit të Komunës së Vushtrrisë 01nr.85/17, dt.30.03.2017 për shpalljen e ankandit publik dhe 01nr.123/17 dt. 27.04.2017 për ndryshimin dhe plotësimin e vendimit lidhur me shpalljen e ankandit publik, Kryetari i Komunës merr këtë:

V E N D I M PËR FORMIM TË KOMISIONIT

1. Me këtë vendim formohet komisioni për vlerësim të materialit të objektit të tanishëm të komunës dhe një pjese të Qendrës së Kulturës "Hasan Prishtina" në Vushtrri që janë planifikuar të rrenohen këtë vit, që do të mund të vohet për shitje nëpërmes ankandit publik.
2. Komisioni ka këtë përbërje:
 - 2.1 **Ramiz Maliqi**, kryesues i komisionit
 - 2.2 **Mexhit Perqaku**, anëtar
 - 2.3 **Latif Beqiri**, anëtar
3. Komisioni në përbërje të cekur në pikën paraprake duhet të jap vlerën fillestare të materialit të objektit të tanishëm të komunës dhe një pjese të ndërtesës së QK "Hasan Prishtina" si: pullazi, dyer dhe dritare, kaldaj i nxehtë qendrorë, kondicionerë, radiatorë si dhe gjësende tjera (përfshijto inventarin zyrtar) të cilat nuk janë të nevojshme për komunën me rastin e kalimit në objektin e ri.
4. Komisioni për punën e tij do të paraqes raport me shkrim në forëm të paramasës dhe parallogarisë dhe dorëzoj Kryetarit të Komunës dhe Drejtorit për Prokurim publik për procedim të mëtejshëm.
5. Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.
6. Vendimi i dërgohet anëtarëve të komisionit dhe arkivit të sekretarisë.



Kryetari i Komunës
Bajram Mulaku



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVO	
KOMUNA E VUSHTRRIË-OPËTINA VUÇITRN	
62 Nr. / Nr.	709/17
Nr. i sq. / Nr. si	
Data / Datum	08.06.2017
VUSHTRRI - VUÇITRN	



REPUBLIKA E KOSOVËS
KOMUNA VUSHTRRI

Bazuar në nenin 13 dhe 58 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, nenin 11 të Ligjit për Shpronësimin e Pronës së Paluajtshme Nr.03/L-139 me ndryshimet dhe plotësimet e bëra me Ligjin Nr.03/L-205, dt. 28 tetor 2010, dhe nenin 67 "g" të Statutit të Komunës, Kryetari i Komunës, me datën 06.06.2017, merr këtë:

VENDIM PËRFUNDIMTAR

1. Miratohet shpronësimi për interes publik, realizimin e projektit për ndërtimin e sheshit në qytetin e Vushtrrisë, Komuna e Vushtrrisë, të pronës të paluajtshme si në vijim:

• O-70202016-06006-0-70-1-3-0, pjesë e ndërtesës-lokal në sipërfaqe prej 60m², nga sipërfaqja e përgjithshme prej 60 m², ZK-Vushtrri, me pronar (qira mbajtje për 99 vite) në pjesë ideale 1/1 Ndërmarrja e Re Zyra e Jugobankës Vushtrri Sh.P.K me seli në Vushtrri, përfaqësuar nga Izet Maliqi nga Vushtrria, rr. "G.J.K. Skënderbeu", Komuna Vushtrri.

2. Për pronën e shpronësuar, do të paguhet kompensimi në emër dhe llogari të pronarit të cekur në nenin 1 të këtij Vendimi, apo zotëruesit të interesit, në bazë të akt vlerësimeve të Ministrisë së Financave – Departamentit të Tatimit në pronë dt.06.04.2017.
3. Akt vlerësimi është pjesë përbërëse e këtij vendimi dhe i është bashkangjitur në shtojcë.
4. Brenda 2 (dy) viteve nga data e hyrjes në fuqi të këtij vendimi do të paguhet në tërësi shuma e kompensimit për pronën e shpronësuar me këtë vendim.
5. Brenda 5 (pesë) ditëve të punës pas miratimit të këtij vendimi, i njëjti i dërgohet personit prona e të cilit është shpronësuar.

6. Brenda 10 (dhjetë) ditëve të punës pas miratimit të këtij vendimi, i njëjti do të shpallet në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës dhe në një gazetë me tirazh më të madh në Kosovë.
7. Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdesen: Drejtoria për Buxhet dhe Financa dhe Drejtoria për Gjeodezi Kadastër dhe Pronë në Vushtri.
8. Ky vendim hyn në fuqi në ditën e shpalljes në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës dhe në një gazetë me tirazh më të madh në Kosovë.
9. Kundër këtij vendimi mund të paraqitet ankesë brenda 30 (tridhjetë) ditëve kalendarike pas hyrjes në fuqi të të njëjtit. Ankesa paraqitet në Gjykatën Themelore në Mitrovicë- dega në Vushtri dhe ka të bëjë vetëm me kundërshtimin e shumës së kompensimit të përcaktuar me këtë vendim. Në të njëjtën ditë në të cilën dorëzohet ankesa në Gjykatë, parashtruesi i ankesës duhet që menjëherë dhe drejtpërdrejt të dorëzoj në zyrën ligjore të organit shpronësues (Komunës së Vushtrrisë) 5 (pesë) kopje të sakta dhe të plota të ankesës, duke përfshirë të gjitha dokumentet përcjellëse që e arsyetojnë ankesën.



Kryetari i Komunës

Bajram Mulaku

REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLICA E KOSOVË	
KOMUNA E VUSHTRISË - КОМУНА ВУШТРИ	
KZ Nr. / Nr.	743 / 17
Pr. / Sp. / Sa. / Nr.	
Udhë / Datim	19.06.2017
VUSHTRRI - ВУШТРИ	

Bazuar në nenin 5 paragrafi 2 të Marrëveshjes së Mirëkuptimit për Ofrim të Sigurisë Fizike në Ndërtesën e Komunës së Vushtrrisë, në mes të Komunës së Vushtrrisë dhe Policisë së Kosovës, 02nr. 597/17, dt. 16.05.2017 lidhet kjo:

ANEKS MARRËVESHJE MIRËKUPTIMI PËR OFRIM TË SIGURISË FIZIKE NË NDËRTESEN E KOMUNËS NË VUSHTRRI

Palët e marrëveshjes:

1. KOMUNA Vushtrri, Sheshi "Hasan Prishtina" nr. 173
2. POLICIA E KOSOVËS, Rr. "Luan Haradinaj" në Prishtinë (në tekstin vijues: punëmarrësi- kryesi i shërbimeve të sigurimit) si palë e dytë.

Neni 1

Ofrimi i sigurisë fizike në ndërtesën e Komunës së Vushtrrisë bëhet nga data 20.06.2017 gjerë më 31.12.2017 në mënyrën dhe kushtet e paraqitura si në marrëveshjen bazë.

Neni 2

Kjo aneks marrëveshje hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.

Neni 3

Kjo aneks marrëveshje është përpiluar në dy ekzemplarë në origjinal, që nënkupton nga një për secilën palë nënshkruese.

NËNSHKRIMI I PUNËDHËNËSIT

Kryetari i Komunës
z. Bajram Mulaku





Tel. kontaktues: 028/571-524
045 400-588



NËNSHKRIMI I PUNËMARRËSIT

Kolonel Taibe Canolli Brajshori
Drejtor i Divizionit për Personel dhe Administratë
Drejtoria e Përgjithshme e Policisë Prishtinë

Tel-kontaktues: 045 400-5711
045 400-588



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVO
KOMUNA E VUSHTRRISË - OPŠTINA VUÇITRAN

№ Nr. / Nr. _____ 747 / 17
Nr. i Shp. / Sh. nr. _____ -02-
Data / Ditë _____ 19.06.2017

VUSHTRRI - VUÇITRAN



REPUBLIKA E KOSOVËS - KOMUNA VUSHTRRI
Kryetari

Në bazë të nenit 6 të Ligjit për Auditimin e Brendshëm nr. 03/L-128 të Kuvendit të Republikës së Kosovës për Auditimin e Brendshëm dhe neni 3 dhe 5 të Udhëzimit Administrativ nr. 11/2010 për Themelimin dhe Funksonimin e Komitetit të Auditimit në Subjektin e Sektorit Publik, Kryetari i Komunës merr këtë:

V E N D I M

PËR THEMELIMIN E KOMITETIT TË AUDITIMIT NË KOMUNËN E VUSHTRRISË

1. Me këtë vendim, themelohet Komiteti i Auditimit në Komunën e Vushtrrisë, në këtë përbërje:
 - 1.1 Sahit Surdulli, kryesues
 - 1.2 Vlora Pllana, anëtar
 - 1.3 Nasuf Aliu, anëtar
2. Mandati i Komitetit të Auditimit është 3 vjet nga dita e emërimit.
3. Komiteti, detyrat e tij do të i kryej konform dispozitave të Ligjit për Auditimin e Brendshëm dhe Udhëzimit Administrativ për Themelimin dhe Funksonimin e Komitetit të Auditimit në subjektin e Sektorit Publik.
4. Drejtori i Njësisë së Auditimit të Brendshëm të Komunës është sekretar i Komitetit të Auditimit i cili do të ndjek të gjitha takimet e Komitetit.
5. Komiteti i Auditimit duhet të mbledhet së paku 4 herë në vit, por Kryesuesi mund të thërrasë mbledhje shtesë sipas nevojës.
6. Për çdo takim të Komitetit të Auditimit, sekretari mban procesverbalin dhe shënimet gjithëpërfshirëse të shkruara në lidhje me të gjitha çështjet e diskutuara. Procesverbalet mbahen në NJAB në pajtim me dispozitat ligjore apo nënligjore me të cilat është e rregulluar kjo çështje.
7. Komiteti i Auditimit përgatitë Raportin vjetorë për menaxhmentin e lartë të subjektit të sektorit publik.

8. Ky vendim hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.
9. Vendimi i dërgohet: secilit anëtarë të Komitetit të Auditimit, Drejtorit të NJAB dhe Arkivit të Sekretarisë.



Kryetari i Komunës

Bajram Mulaku



REPUBLICA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVO
KOMUNA E VUSHTRRISË - OPËTINA VUČITRN

02 Nr./Br. 753/17 **MARRËVESHJE PËR BASHKËPUNIM – (MpB)**

Nr./Ip./Br. nr. _____

Data / Datum 22.06.2017

VUSHTRRI - VUČITRN

në mes të

**Initiativa për Zhvillimin e Bujqësisë së Kosovës me regjistrim
Nr: 5200122-6 –në tekstin e mëtejme i referuar si “IADK”**

dhe

Komuna Vushtrri

I. Lënda e MpB

“IADK”-ja dhe “Komuna e Vushtrrisë” pajtohen të rregullojnë një bashkëpunim të afërt me qëllim të ruajtjes së vazhdimësisë së projekteve bujqësore të realizuara nga “IADK”-ja në Komunën e Vushtrrisë.

“IADK” është duke zbatuar projektin “Promovimi i sektorit të bujqësisë si nxitës i rritjes ekonomike dhe punësimit” në komnat: Lipjan, Shtime dhe Vushtrri, përkrahur nga Deutsche Gesellschaft für Internationale Zusammenarbeit (GIZ) GmbH, i mandatuuar nga Qeveria e Republikës Federale të Gjermanisë.

Kjo MpB ka qëllimin të përshkruajë bashkëpunimin në mes të “IADK”-së dhe “Komunës së Vushtrrisë” gjatë periudhës Qershor 2017 – Dhjetor 2017 për pikat, të drejtat dhe detyrat për secilën palë të kyçur, ku si qëllim i fundit është ndihma dhe përkrahja e fermerëve të cilët do të jenë në gjendje të prodhojnë për nevoja të veta dhe për treg.

Palët e lartë cekura pajtohen që MpB-ja të përmbajë këto obligime dhe përgjegjësi:

II. Obligimet e Komunës së Vushtrrisë

- “Komuna e Vushtrrisë” në bashkëpunim me “IADK”-në do t’i koordinojnë aktivitetet në sektorin e bujqësisë sipas projektit të financuar nga GIZ.
- “Komuna e Vushtrrisë” do të ofroj hapësirat për sesione informuese dhe trajnime me fermerë dhe përfituesit e granteve.
- “Komuna e Vushtrrisë” do të sigurojë informacione rreth listave të përfituesve nga grantet e komunës, lista të personave të kthyer, përfitues nga grantet MBPZHR dhe nga donatorë tjerë.
- “Komuna e Vushtrrisë” do të caktoj një punonjës civil i cili do të jetë i involvuar në projektin e “IADK”-së dhe do t’u ndihmojë stafit të “IADK”-së me material të

nevojshëm, do të jetë pjesë e zbatimit të projektit gjatë zgjedhjes së përfituesve dhe monitorimit të projektit.

- “Komuna e Vushtrrisë” do të lejojë hapësirë për vendosjen e materialeve të ndryshme siç janë listat e përfituesve, materialet informuese si dhe forma tjera të komunikimit me palët e interesit.

III. Obligimet e “IADK”-së

- “IADK” në kuader të projektit “Promovimi i sektorit të bujqësisë si nxitës i rritjes ekonomike dhe punësimit” do të përkrahë 43 përfitues me grante bujqësore, ky numër mund të ndryshojë varesisht nga plotësimi i kriterëve.
- Secili përfitues do të përfitojë:
 - Grant me vlerë 2000 € të përkrahur nga projekti dhe rreth 15% - 20% kontribut financiar nga përfituesi,
 - 5 sesione të drejtpërdrejta këshillimore,
 - 2 trajnime,
 - Informata për fermerët në lidhje me shitjet, çmimet e produkteve, promovimin më të mirë në lidhje me kompanitë e përpunimit. Promovimi i praktikave bujqësore të qëndrueshme mjedisore.
 - Monitorim dhe këshillim të vazhdueshëm.
- “IADK” së bashku me “Komuna e Vushtrrisë” do të caktojnë vendin e mbajtjes së sesioneve të trajnimeve dhe shtrirjen gjeografike të projektit.
- IADK do të bashkëpunojë ngushtë gjatë gjithë procesit të projektit, që nga caktimi i kriterëve për përzgjedhje, sesione informuese, zgjedhje të përfituesve, furnizimi dhe monitorimet e rregullta.
- “IADK” do të pajisë përfituesit me të mira për grant dhe materiale edukuese në secilën temë të trajnimit.

IV Përgjegjësit tjera

- “IADK” do të raportojë tek “Komuna e Vushtrrisë” për rezultatet e arritura nga aktivitetet e realizuara në kuadër të kësaj MpB.

VI Personat Kontaktues

- “IADK”-ja dhe “Komuna e Vushtrrisë” do të emërojnë nga një përfaqësues që të rregullojnë kontaktet më të lehta dhe të drejtpërdrejta në mes dy partnerëve. Këta persona do të përfshihen drejt për së drejti në implementimin e qetë dhe kohor të kësaj MpB.
- Nënshkruarit e kësaj MpM kanë të drejtë të nominojnë persona tjerë nëse personat e parë të propozuar nuk bashkëpunojnë mirë.

VII Hyrja në fuqi dhe ndërprerja

Kjo MpB vlen nga muaji Qershor 2017 – Dhjetor 2017, dhe hyn në fuqi duke filluar nga data e nënshkrimit nga të dy palët.

Për modifikimin e kësaj MpB palët duhet të vendosin para skadimit të afatit.



INITIATIVE FOR AGRICULTURAL DEVELOPMENT OF KOSOVO
INICIATIVA PËR ZHVILLIMIN E BUJQËSISË SË KOSOVËS
INICIATIVA ZA POLJOPRIVREDNI RAZVOJ KOSOVA



Komuna Vushtri

Në rast të mosmarrëveshjes/pakënaqësisë nga ndonjëra palë, MpB mund të ndërpritet para afatit të paraparë duke dhënë një njoftim me shkrim 1- muaj më parë.

VIII Mospajtimet

Të dy palët në çdo kohë do të respektojnë dhe nderojnë kodin e sjelljes të partnerit të tyre, me kujdes të veçantë në pozicionet e paraqitura më lartë.

Iniciativa për Zhvillimin e Bujqësisë së
Kosovës (IADK)

Zenel Bunjaku
Drejtor Ekzekutiv



Vushtri 22/06 / 2017

Komuna e Vushtrrisë

Bajram Mulaku
Kryetar



Vushtri 22.06 . 2017